



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 6 korrik 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratuan procesverbalet e mbledhjeve të Bordit nr. 25, datë 05.06.2026; nr. 26, datë 12.06.2026; nr. 27, datë 15.06.2026; nr. 28, datë 22.06.2026 dhe nr. 29, datë 29.06.2026.

U vendos pezullimi i vendimmarrjes lidhur me kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

U miratua kërkesa e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe të licencës së furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k.

U miratua kërkesa e shoqërisë “NEXORA ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH)” sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et Lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 MW.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.